



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA THEMELORE GJILAN

Numri i lëndës: 2019:083788

Datë: 28.05.2019

Numri i dokumentit: 00332017

PKr. nr. 49/2019

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN - Departamenti i Krimeve të Rënda, sipas kryetarit të trupit gjykues, Agim Ademi me zyrtaren ligjore Xhemile Bejtullahu, në lëndën penale kundër të akuzuarit L. H. nga Gjilani të cilin sipas detyrës zyrtare e mbron avokati Avdullah Ismajli nga Gjilani, për shkak të veprës penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.1. të KPRK-ës, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjilani - Departamenti për Krime të Rënda PP.I. nr. 54/2019, të datës 28.03.2019, të cilën e përfaqëson prokurori Arben Kadriu, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar dhe publik, më datën 24.05.2019, bie dhe në prezence të palëve publikisht shpalli këtë :

A K T G J Y K I M

I akuzuari

L. H. nga i ati dhe e ëma, e lindur, i lindur me datë, në Gjilani ku edhe jeton, lagjja “Arbëria” rr. “.....” nr. 25, i martuar, baba i tre fëmijëve, i pa punësuar, ka të kryer shkollën e mesme, i gjendjes së varfër ekonomike, Shqiptar, Shtetas i Republikës së Kosovës dhe Shtetas i Shtetit të Zvicrës, me nr. personal

ESH TË FAJTOR

Se me datë 27 janar, rreth orës 00:50 min, në Gjilan, në rrugën “Muharrem Ibrahim””, i akuzuari pa autorizim dhe pa leje valide, e në kundërshtim të Ligjit të Zbatueshëm për Armët, ka mbajtur në pronësi, kontroll ose posedim një sprej lotsjellës “Peper Box” dhe një brisk, të cilat i janë sekuestruar nga Policia e Kosovës.

-Me çka ka kryer veprën penale mbajtja ne pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par. 1 të KPRK-ës.

Andaj, gjykata në bazë të neneve 7,17, 21,41,46,69,73,114, nenit 374 par.3 të KPRK-së si dhe neneve 365 dhe 453 të KPPRK-ës .

E G J Y K O N

Të akuzuarin L. H., i shqiptohet dënim me gjobë në shumë prej 250 (dyqind e pesëdhjetë) euro, nëse i akuzuari nuk e paguan dënimin me gjobë atëherë të njëjtit do ti zëvendësohet me dënim burgu duke iu llogaritur nga 20 euro për një ditë burgimi.

Të akuzuarit L. H. i shqiptohet edhe dënim plotësues konfiskimi i sprejtit lotsjellës “Peper Box” dhe briskut.

Obligohet i akuzuari që në emër të paushallit gjyqësor të paguajnë shumën prej 30 (tridhjetë) euro dhe shpenzimet e procedurës sipas llogarisë përfundimtare të Gjykatës si dhe 50 (pesëdhjetë) euro për viktimat e krimit dhe shpenzimet e procedurës sipas llogarisë përfundimtare të Gjykatës.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Gjilan - Departamenti për Krime të Rënda ka paraqitur aktakuzë PP.I nr. 54/2019, të datës 28.03.2019, kundër të akuzuarit L. H., nga Gjilani, për shkak të veprës penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.1. të KPRK-ës, dhe ka kërkuar që i akuzuari të shpallet fajtor dhe të dënohet me dënim meritor sipas ligjit.

Prokurori i Prokurorisë Themelore në Gjiilan - Departamenti për Krime të Rënda Arben Kadriu, fillimisht mbeti në tërësi pranë aktit akuzues derisa më pas shtoi se nuk ka vërejtje në pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit dhe në deklarinimin mbi dënimin shtoi se pasi që pranimi i fajësisë është bërë në mënyrë vullnetare dhe një pranim i tillë është i mbështetur në provat të cilat gjenden në shkresat e lëndës, janë plotësuar kushtet për pranimin e fajësisë. Andaj, i propozoi gjykatës që të akuzuarin ta shpall fajtor dhe ta dënoj sipas KPRK-ës duke i marrë parasysh rrethanat lehtësuese dhe rënduese. Po ashtu propozojmë që të akuzuarit të i shqiptohet dënimi plotësues konfiskimi i sprejit lotsjellës dhe briskut.

I akuzuari L. H. fillimisht e pranoi fajësinë për veprën penale që i vihet në barrë dhe se këtë pranim të fajësisë e bëri vullnetarisht pa u ndikuar nga askush dhe pranimi i fajësisë i është aprovuar me aktvendim nga ana e gjykatës. I akuzuari në deklarinimin e tij për dënimin në fjalën përfundimtare i propozoi gjykatës që ti i shqiptoj një dënim sa më i butë duke premtuar që në të ardhmen nuk do të kryej vepra penale tjera, njëkohësisht që ndjen keqardhje për kryerjen e kësaj vepre penale.

Mbrojtësi i të akuzuarit L. H., avokat Avdullah Hoti nga Gjilani në fjalën përfundimtare lidhur me dënimin deklaroi se duke pasur parasysh se i mbrojturi im në të gjithat fazat e procedurës ka qenë kooperativ dhe i sinqertë, kërkojë nga gjykata që me rastin e matjes së dënimit të njëjtit ti shqiptoj një dënim të ulët edhe atë me gjobë, pasi që konsideroj se edhe ai dënim do të jep efektin duhur.

I akuzuari në deklarinimin e tij për dënimin i propozoi gjykatës që ti i shqiptoj një dënim sa më i butë duke premtuar që në të ardhmen nuk do të kryej vepra penale tjera, njëkohësisht që ndjen keqardhje për kryerjen e kësaj vepre penale.

Gjykata analizoi provat të cilat gjenden në shkresat e lëndës, dhe atë: raporti i oficerit i datës 20.03.2019, raporti fillestar i incidentit me nr. 2019-CI-9 i datës 27.01.2019, dëftesat mbi konfiskimin e pronës të datës 27.01.2019 dhe me vet pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit L. H., erdhi në përfundim se me datë 27 janar, rreth orës 00:50 min, në Gjiilan, në rrugën “Muharrem Ibrahimit”, i akuzuari pa autorizim dhe pa leje valide, e në kundërshtim të Ligjit të Zbatueshëm për Armët, ka mbajtur në pronësi, kontroll ose posedim një sprej lotsjellës “Peper Box” dhe një brisk, të cilat i janë sekuestruar nga Policia e Kosovës dhe në këtë mënyrë e ka kryer veprën penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par. 1 të KPRK-ës.

Me rastin e caktimit të llojit dhe të lartësisë së dënimit Gjykata pati parasysh rrethanat të parapara me nenin 73 të KPK-ës, dhe si rrethanë lehtësuese gjeti se i akuzuari e ka pranuar fajësinë duke shprehur keqardhje të thellë, pati sjellje të mira në Gjykatë, premtimi i tij se në të ardhmen nuk do të kryej vepra penale. Ndërsa si rrethanë rënduese pati parasysh shkallën e rrezikshmërisë shoqërore duke qenë se posedimi i armës pa leje paraqet rrezik për popullatën,

Vendimi mbi dënimin plotësues konfiskimi i armës – sprejit lotsjellës dhe briskut, është bazuar në nenin 69 par.1 dhe 374 par.3 të KPRK-së.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale është i bazuar në nenin 453 të KPPRK-së.

Nga të cekurat më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN
DEPARTAMENTI I KRIMEVE TË RËNDA
PKR.nr. 49/19 Me datë.24.05.2019

Zyrtare ligjore
Xhemile Bejtullahu

Kryetari i trupit gjykues
Agim Ademi

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa Gjykatës së Apelit në Prishtinë Departamenti i Përgjithshëm, në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimi të së njëjtës, ankesa dorëzohet në dy ekzemplar përmes kësaj Gjykate.